 - 4.12. Të sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit dhe ta marrë miratimin;
 - 4.13. Të menaxhojë dorëzimet e procedurave të pranimit të punëve, të mallrave dhe të shërbimeve;
 - 4.14. Të japë detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit; dhe
 - 4.15. Të dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontrate, siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit, ose nga ZKA-ja.
5. Përgjegjësitë e Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, janë:
 - 5.1. Monitorimi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës; dhe
 - 5.2. Rishikimi, aprovimi dhe procesimi i vlerësimit të performancës së kontraktuesit – vlerësime të propozuara nga menaxherët e kontratave, nën mbikëqyrjen e tij.
 6. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me Nr. Prot. 02/6660 i datës 23.10.2025.
 7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- **Menaxheri i kontratës,**
- **Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,**
- **Sektori i Prokurimit, dhe**
- **Arkivi.**

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës
Zyrtar Kryesor Administrativ





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECI/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNES/ABINET PRESEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 7684 Nr. i faq./Br.sht./No.pg 71
Data/Datum/Datë 22 / 07 / 26
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 90 të Ligjit Nr. 04/L-027 për Mbrojtjen nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 22/2011"), nenit 8 paragrafi 2 pika 2.2, nenit 9 dhe nenit 12 të Rregullores (QRK) – Nr. 17/2015 për metodologjinë e vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, dhe nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në të mirat materiale nga ndikimi i fatkeqësive natyrore dhe i fatkeqësive të tjera

- 1. Caktohet komisioni komunal për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në të mirat materiale nga ndikimi i fatkeqësive natyrore dhe i fatkeqësive të tjera në territorin e komunës së Rahovecit, në këtë përbërje:**
 - 1.1. Veton Mustafa, kryesues,**
 - 1.2. Sokol Thaqi, anëtar,**
 - 1.3. Albina Durguti, anëtare,**
 - 1.4. Jetmir Ukaj, anëtar,**
 - 1.5. Mimoza Isma, anëtare.**
- 2. Komisioni komunal për vlerësimin e dëmeve, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera, Rregulloren (QRK) – Nr. 17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera, si dhe në legjislacionin përkatës në fuqi.**
- 3. Mandati i komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve është 4 (katër) vjet.**
- 4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi me nr. prot. 4383, faqe 142, i datës 2.7.2024.**
- 5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.**

Me vendim të njoftohen:

- Anëtarët e komisionit,**
- Drejtorët e drejtorive,**
- Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave në MPB, dhe**
- Arkivi.**

Smail Latifi
Kryetar i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 7685 Nr. i faq./Br.str/No.pg 71

Data/Datum/Date 22.07.26

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 21 dhe 26 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/2016"), nenit 11 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 13/2019"), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
Për qasje në dokumente publike

1. **Miratohet** e bazuar kërkesa me nr. prot. 7657, e datës 14.7.2026, për qasje në dokumente publike nga Ardijan Durguti nga Rahoveci, dhe i ofrohet qasje e **plotë** në dokumente publike, respektivisht: *Dokumentacionin publik që lidhet me procedurën e konkursit me numër të references RN00019497*, të shpallur nga Komuna e Rahovecit., konkretisht, në këto dokumente:

Vendimin për emërimin/formimin e antarëve të Komisionit për testin me shkrim.

Vendimin për emërimin/formimin e antarëve të Komisionit për intervistë me gojë.

Procesverbalin/Formularin e mbajtjes së intervistës nga Komisioni i Përzgjedhjes.

Kriteret dhe metodologjinë e vlerësimit të intervistës që janë përdorur nga Komisioni.

Çdo dokument tjetër zyrtar që përcakton mënyrën e vlerësimit të kandidatëve gjatë intervistës, nëse ekziston.

2. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Në mbështetje të nenit 10, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (QDP), Komuna e Rahovecit ka pranuar kërkesën me nr. prot. . 7657, e datës 14.7.2026, për qasje në dokumente publike nga Ardijan Durguti nga Rahoveci,

Pas shqyrtimit të kërkesës, ofrohet qasje e **plotë** në dokumente publike si në dispozitiv të këtij vendimi, respektivisht *dokumentacionin publik që lidhet me procedurën e konkursit me numër të references RN00019497*, të shpallur nga Komuna e Rahovecit., konkretisht, në këto dokumente:

Vendimin për emërimin/formimin e antarëve të Komisionit për testin me shkrim.

Vendimin për emërimin/formimin e antarëve të Komisionit për intervistë me gojë.

Procesverbalin/Formularin e mbajtjes së intervistës nga Komisioni i Përzgjedhjes.

Kriteret dhe metodologjinë e vlerësimit të intervistës që janë përdorur nga Komisioni.

Çdo dokument tjetër zyrtar që përcakton mënyrën e vlerësimit të kandidatëve gjatë intervistës, nëse ekziston.

Kërkesa për qasje në dokumente publike është pranuar në mënyrë elektronike.

Komuna e Rahovecit, pas shqyrtimit të kërkesës, si dhe pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë në Agjencinë për Informim dhe Privatësi brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e pranimi të tij.

Vendimi u dërgohet:

- *Blerta Gashit, Zyrtare për shqyrtimin fillestar të QDP-së,*
- *Ardijan Durguti nga Rahoveci, dhe*
- *Arkiviti.*





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.4 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e [REDACTED] nga Rahoveci me Nr. Protokolit 06-553/01-0024850/26 dt. 22.07.2026 për ndihmë financiare prej 600.00€ (gjashtëqind euro) për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes).
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

[REDACTED] nga Rahoveci me datë 22.07.2026 ka parashtuar kërkesë për ndihmë financiare për lehoninë (lindje) pasi që me datë 17.07.2026 ka lindur **Vajzë** në QKMF "Dr. Fahredin Hoti" në Rahovec.

Marrë parasysh se, e lartpërmendura nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme dhe me këtë rast e njëjta pas shpenzimeve të lindjes e ka të vështirë përballimin e shpenzimeve të blerjes së gjërave elementare për fëmijën, është e domosdoshme ndihma financiare për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë për [REDACTED] si dhe ndihma për sigurimin e gjërave elementare për foshnjën.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

Me vendim të njoftohen:

- [REDACTED] nga Rahoveci,
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



	REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC	
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESIDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET		
Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)		
Nr./Br./No	7690	Nr. i faq./Br.str./No.pg 71
Data/Datum/Date	24 / 07 / 26	
RAHOVEC / ORAHOVAC		

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 63, 74 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017 dhe duke shqyrtuar kërkesën me nr. 14/2026, të datës 14.7.2026 e OJQ “Forumi Anadrini” nga Rahoveci, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa me nr. 14/2026, e datës 14.7.2026 e OJQ “Forumi Anadrini” nga Rahoveci, për huazim dhe shfrytëzim të përkohshëm të artefakteve të Muzeut “Ukshin Hoti” në Krushë të Madhe, me qëllim të organizimit të edicionit të tretë (3) të FARD FEST 2026, i cili do të mbahet më 2 dhe 3 gusht 2026, në Kompleksin Memorial në Gradish të fshatit Xërxë.
2. Formohet komisioni për dorëzimin e përkohshëm dhe pranim - dorëzimin e artefakteve të Muzeut “Ukshin Hoti” në Krushë të Madhe, në përbërje prej:
 - 1.1. Blerim Shala, kryesues,
 - 1.2. Irfon Ramadani, anëtar,
 - 1.3. Granita Behra, anëtare.
3. Obligohet komisioni që, gjatë dorëzimit për shfrytëzim të përkohshëm të artefakteve të Muzeut “Ukshin Hoti” në Krushë të Madhe, të garantojë proces të rregullt dhe transparent të pranim – dorëzimit të artefakteve dhe të bëjë vlerësimin e gjendjes së tyre si gjatë dorëzimit ashtu edhe gjatë pranimin të tyre.
4. Obligohet komisioni që, pas përfundimit të punëve, të hartojë raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe për Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Rahovecit.
5. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë brenda një afati të arsyeshëm.
6. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

1. Anëtarëve të komisionit,
2. Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport,
3. OJQ “Forumi Anadrini”, dhe
4. Arkivit.

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale në Kosovë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës”, Nr. 28/2008), nenit 63, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafët 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, datë 29.3.2017, konkursit tradicional, kulturor e përkujtimor “Flaka e Janarit”, të shpallur nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, më 6.1.2026 dhe në bazë të raportit të jurisë profesionale, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për ekzekutimin e mjeteve financiare për fituesit e çmimit “Flaka e Janarit”

1. Me këtë vendim lejohet ekzekutimi i mjeteve financiare për fituesit e manifestimit tradicional, kulturor të çmimit “Flaka e Janarit”, si në vijim:

1.1. Vendi i parë – Melisa Hoti, në shumën 200 € (dyqind euro).

Mjetet të alokohen në emër të prindit Muhamet Hoti, me nr. personal 1171458451, në xhirollogarinë bankare me nr. 1505010002031930, Raiffeisen Bank.

1.2. Vendi i dytë – Tiara Krasniqi, në shumën 150 € (njëqind e pesëdhjetë euro).

Mjetet të alokohen në emër të prindit Albesa Krasniqi, me nr. personal 1231517592, në xhirollogarinë bankare me nr. XK051931772819021154, BKT Bank.

2. Mjetet do të sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit.

A r s y e t i m

Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Rahovecit, më datë 6.1.2026, ka shpallur konkursin tradicional, kulturor e përkujtimor “Flaka e Janarit” për të gjithë pjesëmarrësit e interesuar, të rinjtë dhe nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme në komunën e Rahovecit, në fushën e artit letrar, të poezisë dhe të prozës.

Kjo drejtori, duke u bazuar në raportin e jurisë profesionale pas vlerësimit të të gjitha punimeve letrare të paraqitura për fitimin e çmimit tradicional, kulturor e përkujtimor “Flaka e Janarit”, ka shpallur fituesit në bazë të vlerësimit të jurisë profesionale dhe ia ka paraqitur Kryetarit të Komunës për miratim dhe lejimin e ekzekutimit të mjeteve për fituesit e çmimit.


Vendimi u dërgohet:

- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport,
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 28 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 18/2011"), nenit 19 paragrafi 19.16 i Rregullores Nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e personit përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës për aktivitetin e prokurimit: "Renovimi dhe riparimet e objekteve të QMF – ve dhe AMF – ve në komunën e Rahovecit"

1. Sylejman Daka, **emërohet** person përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës për aktivitetin e prokurimit: **"Renovimi dhe riparimet e objekteve të QMF – ve dhe AMF – ve në komunën e Rahovecit"**.
2. Personi përgjegjës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, ka për detyrë që të bëjë hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës, duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik dhe Rregulloren Nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.
3. Përgjegjësitë e personit për hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës, janë:
 - 3.1. Në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomikë, në përputhje me nenin 28 Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe akteve nënligjore (legjislacionit dytësor);
 - 3.2. Në atë mënyrë që nuk favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomikë;
 - 3.3. Të cilat nuk i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, një procesi të hollësishëm, ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë, ose ndonjë prodhimi.

4. Personi përgjegjës obligohet që të hartojë specifikimet teknike / termat e referencës deri më datë 5.8.2026.
5. Personi përgjegjës obligohet që, së bashku me specifikimet teknike / termat e referencës, të dorëzojë edhe deklaratën në betim, të nënshkruar te Njësia e Prokurimit.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- *Sylejman Daka,*
- *Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale*
- *Njësia e Prokurimit, dhe*
- *Arkivi.*





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec



KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINETI PRESEDIRA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 7699 Nr. i faq./Br.str./No.pg 72
Data/Datum/Date 29/7/2026
RAHOVEC / ORAHOVAC

Zyra e Kryetarit të Komunës së Rahovecit, duke shqyrtuar ankesën me nr. 2450, të datës 6.7.2026, të paraqitur nga Nuredin Kastrati, me nr. personal 10025850636, nga fshati Radostë, komuna e Rahovecit, kundër vendimit me nr. 10, të datës 12.2.2026, të Drejtorisë për Shërbime Publike, refuzimit për furnizim me gypa të kanalizimit fekal, në gjatësi prej 350 m, duke u bazuar në nenin 13 dhe nenin 58 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), nenin 74 dhe nenin 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, nr. 1005, i datës 29.3.2017, nenet 3, 21, 22, 44 dhe 131 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative nr. 05/L-031, të datës 25.5.2016, merr këtë:

V E N D I M

1. REFUZOHET ankesa me nr. 2450, e datës 6.7.2026, e paraqitur nga [redacted] nga fshati [redacted] komuna e Rahovecit, me nr. personal [redacted] kundër vendimit me nr. 10, të datës 12.2.2026, të Drejtorisë për Shërbime Publike - refuzimit për furnizim me gypa të kanalizimit fekal, në gjatësi prej 350 m, si e pabazuar.

A r s y e t i m

Zyra e Kryetarit të Komunës së Rahovecit, duke shqyrtuar ankesën me nr. 2450, të datës 6.7.2026, e paraqitur nga [redacted] komuna e Rahovecit, kundër vendimit me nr. 10, të datës 12.2.2026, të Drejtorisë për Shërbime Publike, me të cilin është refuzuar kërkesa për furnizim me gypa të kanalizimit fekal në gjatësi prej 350 m dhe pas vlerësimit të ankesës dhe të shkresave të lëndës, konsideron se ankuesi në ankesë nuk ka paraqitur asnjë provë të bazuar për realizimin e pretendimeve të veta, prandaj e konsiderojmë se ankesa është e pabazuar.

Ankuesi në ankesë pretendon që:

1. Zyra e Kryetarit të Komunës së Rahovecit, pas ekzaminimit të ankesës, gjeti që ankuesi, me ankesë i është drejtuar gabimisht Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, duke mos respektuar aktin administrativ të organit që e ka nxjerrë - refuzuar kërkesën, sepse në pjesën përfundimtare, në udhëzimin juridik, palët e pakënaqura me vendim udhëzohen se duhet t'i drejtohen saktë cilit organ. Pastaj ky organ gjeti se ankesa e ankuesit i është drejtuar gabimisht edhe Drejtorisë Inspektuese për Shërbime Publike. Më duhet t'ju njoftoj se ky emërtim nuk ekziston, sepse në kuadër të organizimit të brendshëm të Komunës së Rahovecit ekziston vetëm Drejtoria për Shërbime Publike. Ky organ gjeti se ankesa e parashtruar ishte e panënshkruar nga parashtruesi i ankesës.

2. Ankuesi pretendon që vendimi i Drejtorisë për Shërbime Publike është i kundërligjshëm dhe jo i bazuar. Konsiderojmë se ky pretendim nuk qëndron dhe nuk është i bazuar, sepse vendimi me nr. 10, i datës 12.2.2026, i Drejtorisë për Shërbime Publike, me të cilin është refuzuar kërkesa për furnizim me gypa të kanalizimit fekal në gjatësi prej 350 m, është i bazuar, sidomos kur e analizojmë vendimin e Drejtorisë për Shërbime Publike. Ai i posedon të gjitha elementet e domosdoshme të një akti administrativ, të përcaktuara me nenin 47 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative nr. 05/L-031, të datës 25.5.2016 (shih pjesën hyrëse). Ky vendim posedon bazën juridike në të cilën është vendosur.

3. Ankuesi në ankesë pretendon se arsyetimi i vendimit është i paqartë. Pretendimin e ankuesit e konsiderojmë se është jo i drejtë, sepse vendimi me nr. 10, i datës 12.2.2026, i Drejtorisë për Shërbime Publike, me të cilin është refuzuar kërkesa, është vendim i cili, në pjesën e arsyetimit, e përshkruan gjendjen aktuale faktike financiare të institucionit, i cili momentalisht, për shkak të mungesës së mjeteve financiare sipas planifikimit të buxhetit 2026, e ka bërë të pamundur edhe përmbushjen e kërkesës, prandaj është vendosur si në dispozitiv të vendimit.

4. Ankuesi në ankesë ka propozuar edhe shfuqizimin e vendimit me nr.10, të datës 12.2.2026, të Drejtorisë për Shërbime Publike. Ky pretendim është jo i drejtë, sepse ankuesi në ankesë nuk ka paraqitur asnjë provë të bazuar, në bazë të së cilës Zyra e Kryetarit do të mund ta shfuqizonte vendimin e Drejtorisë për Shërbime Publike. Ankuesi në ankesë është bazuar vetëm në supozime dhe jo në prova konkrete të bazuara, sepse vendimet e drejta, ligjore dhe të bazuara merren duke u bazuar në prova dhe fakte konkrete e të bazuara.

Zyra e Kryetarit të Komunës së Rahovecit, duke shqyrtuar ankesën me nr. 2450, të datës 6.7.2026, e paraqitur nga [REDAKTUAR] kundër vendimit me nr. 10, të datës 12.2.2026, të Drejtorisë për Shërbime Publike, me të cilin është refuzuar kërkesa për furnizim me gypa të kanalizimit fekal në gjatësi prej 350 m, konsideron që vendimi i Drejtorisë është i drejtë dhe i bazuar, sepse për shkak të gjendjes momentale financiare, respektivisht për shkak të mungesës së mjeteve financiare sipas planifikimit të buxhetit 2026, është bërë e pamundur përmbushja e kërkesës edhe për shkak të gjendjes faktike të vërtetuar në terren (fotografitë dhe procesverballi i datës 9.2.2026). Në fund, në kuadër të kompetencave të veta, Komuna e Rahovecit e ka edhe objektiv që të përmirësojë infrastrukturën dhe kushtet jetësore për të gjithë banorët e komunës së Rahovecit, por gjithmonë brenda mundësive buxhetore, bazuar në planifikimin buxhetor të Komunës. Prandaj është vendosur si në dispozitiv të vendimit.

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë që, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi, të iniciojë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Me vendim të njoftohen:

- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
~~Komuna e Rahovecit~~
~~Opština Orahovac / Municipality Rahovec~~
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Njësia Nr./Br./No. 02/Kabineti i Kryetarit të Komunës
Nr./Br./No. 7700 Nr. i fuq. Br./Br./No. 72
Data/Datum/Date 29 / 7 / 2026
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) nenit 21 të Ligjit për Pagat e nëpunësve civilë Nr.03/L-147, të datës 13.5.2010 dhe nenit 11 të Rregullores Nr. 33/2012 për shtesat në pagat dhe kompensimet e tjera të nëpunësve civilë, neneve 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E PAGESËS PËR PUNË JASHTË ORARIT TË PUNËS

1. Me këtë vendim, **LEJOHET** pagesa për punë shtesë jashtë orarit të punës për znj. Zimrite Nurkasa, e cila është në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe e sistemuar në punët dhe në detyrat e punës: Zyrtare e Gjendjes Civile, në Drejtorinë për Administratë në Komunën e Rahovecit.
2. Vlera e pagesës për punë shtesë jashtë orarit të punës është 30 (tridhjetë euro) për kryerjen e punës, respektivisht për zhvillimin e ceremonisë së martesës – kurorëzimit jashtë orarit të punës dhe jashtë objektit të Komunës së Rahovecit. Më 26.7.2026, ceremonia e martesës – kurorëzimit është kryer jashtë Zyrës së Gjendjes Civile në Rahovec, në mes të çiftit Hajdar Zogaj dhe Florentina Morina.
3. Mjetet për pagesën e punëve jashtë orarit të rregullt të punës sigurohen nga kodi: Paga dhe Mëditje.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Me kërkesën e znj. Zimrite Nurkasa, e cila është në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe e sistemuar në punët dhe në detyrat e punës: Zyrtare e Gjendjes Civile, në Drejtorinë për Administratë në Komunën e Rahovecit dhe me autorizimin e drejtorit për Administratë, të datës 15.7.2026, punëtori i lartcekur ka marrë pjesë më 26.7.2026 në kurorëzimin e shtetasve të Republikës së Kosovës jashtë objektit të Komunës së Rahovecit – jashtë Zyrës së Gjendjes Civile në Rahovec. Prandaj, për shkak të kryerjes së punës – lidhjes së kurorëzimit jashtë orarit të punës, duke u bazuar në legjislacionin në fuqi, është e domosdoshme që të bëhet pagesa për kryerjen e punës.

Me vendim të njoftohen:

- Zimrite Nurkasa,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- Zyra e Personelit, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008), dispozitave të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 21, paragrafi 1, 3 dhe 4, nenit 33, paragrafi 6, si dhe nenit 44, paragrafi 4, nënparagrafi 4.1 dhe paragrafi 5, të Rregullores (QRK) Nr. 22/2020 për Riintegrim, i themeluar me vendimin 02/271 të datës 14.7.2014, Kryetari i Komunës, nxjerr këtë:

VENDIM

1. **MIRATOHET** kërkesa me nr. prot. 2595, e datës 14.7.2026, e [redacted] ahoveci, i riatdhesuar nga Gjermania më 17.6.2024, me dhunë, për pagesën e vazhdimin të qirasë për akomodim, me shumën prej 280 € (dyqind e tetëdhjetë euro), duke përfshirë edhe shpenzimet komunale për mbështetje nga masat emergjente të integritit.
2. Pagesa e qirasë, sipas pikës 1 të këtij vendimi, do të paguhet për gjashtë (6) muaj, duke filluar nga data 1.8.2026 deri më 31.1.2027.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe Ministria e Punëve të Brendshme.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Komisioni Komunal për Riintegrim, në seancën e mbajtur më datë 24.7.2026, ka shqyrtuar kërkesën me nr. prot. 2595 të datës 14.7.2026, e parashtruar nga i riatdhesuar [redacted] ahoveci, për mbështetje nga masat emergjente të riintegritit për akomodim me qira, duke u bazuar në rekomandimet e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim.

I lartpërmenduri po përballlet me një situatë të rëndë socio-ekonomike dhe është në kërkim të strehimit të përkohshëm. [redacted] arësisht se është nga Rahoveci, ka kërkuar strehim në Gjakovë për shkak të një situatë të ndërlikuar familjare. Para luftës, familjarët e tij u larguan nga Rahoveci për shkak të një ndërlikimi në gjakmarrje dhe ai ende ka frikë nga pasojat e mundshme në rast të kthimit, si dhe konsideron që situata e tij kërkon një zgjidhje të përhershme për strehim në Gjakovë.

Kërkesa për akomodim me qira miratohet për periudhën 6 (gjashtë)-muajore, duke filluar nga data 1.8.2026 deri më 31.1.2027, në shumën prej 280 € në muaj, për të vazhduar procesin e trajtimit të statusit të tij me tutje për mbështetje nga niveli komunal, sipas dispozitave të Rregullores (QRK) Nr. 22/2020 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar.

Komisioni ka shqyrtuar të gjitha dokumentet e prezantuara dhe, sipas dëshmive të paraqitura, konstaton që i riatdhesuari i plotëson kriteret për mbështetje nga masat emergjente të integritit, për akomodim, respektivisht sipas nenit 21, paragrafi 1.3 dhe nenit 4, nenit 33, paragrafi 6, si dhe nenit 44, paragrafi 4, nënparagrafi 4.1 dhe paragrafi 5.

Andaj, nga se u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi, te Komisioni për Ankesa në DRPR, përmes Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim në Komunën e Rahovecit.

Me vendim të njoftohen:

- [REDAKTUAR] *nga Rahoveci,*
- *Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim,*
- *Koordinatori rajonal i MPB-së, dhe*
- *Arkivi.*





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.4 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e [redacted] nga Rahoveci me Nr. Protokolit 06-553/01-0025865/26 dt. 28.07.2026 për ndihmë financiare prej 600.00€ (gjashtëqind euro) për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes).
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

[redacted] nga Rahoveci me datë 28.07.2026 ka parashtruar kërkesë për ndihmë financiare për lehoninë (lindje) pasi që me datë 21.07.2026 ka lindur **Djal** në QKMF "Dr. Fahredin Hoti" në Rahovec.

Marrë parasysh se, e lartpërmendura nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme dhe me këtë rast e njëjta pas shpenzimeve të lindjes e ka të vështirë përballimin e shpenzimeve të blerjes së gjërave elementare për fëmijën, është e domosdoshme ndihma financiare për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë për [redacted] dhe ndihma për sigurimin e gjërave elementare për foshnjën.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

Me vendim të njoftohen:

- Znj [redacted] nga Rahoveci,
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivi.

Smajl Latifi
Kryetari i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E ORAHOVAC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINETI PRESIDENKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 7704 Nr. i faq./Br.str/No.pg 73
Data/Datum/Date 30 / 07 / 26
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kërkesën e Fadil Gashit nga fshati Kramovik, me nr. 2906, të datës 29.7.2026, për lirim nga pagesa e taksës komunale për regjistrim të mëvonshëm të fëmijëve dhe shkresës nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, me Nr. 02/251, të datës 1.4.2026, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për lirim nga pagesa e taksës komunale

1. MIRATOHET kërkesa [redacted] nga fshati Kramovik, me nr. 2906, të datës 29.7.2026 dhe LIROHET nga pagesa e taksës administrative - komunale për regjistrim të mëvonshëm të 5 (pesë) fëmijëve në librat amë të të lindurve, në Zyrën për Regjistrimin Civil në Rahovec dhe atë:

- [redacted]
- [redacted]
- [redacted]
- [redacted]
- [redacted]

2. Obligohet Drejtoria për Administratë që t'i mundësojë [redacted] nga fshati Kramovik zhvillimin e të gjitha procedurave për regjistrim të mëvonshëm të fëmijëve në librat amë, në Zyrën për Regjistrimin Civil dhe ta pajisë me të gjitha dokumentet përcjellëse.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Administratë.

4. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

- [redacted]
- Drejtorisë për Administratë, dhe
- Arkivit.

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), dispozitave të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 18/2011, dispozitave të Rregullores Nr. 002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores NR. 001/2022 për Prokurimin Publik, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, kërkesës me nr. 2899, të datës 29.7.2026, për ndryshimin e lokacionit në projektin "Rregullimi dhe riparimi i terreneve sportive", kontratës me nr. të prokurimit 623-23-12344-5-2-1 dhe rekomandimit për ndryshim të lokacionit, menaxherit të kontratës me nr. prot. 2902, të datës 29.7.2026, kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

**Për ndryshimin (kolaudimin) e lokacionit në projektin me titull
"Rregullimi dhe riparimi i terreneve sportive"**

1. Me këtë vendim lejohet ndryshimi (kolaudimi) i lokacionit nga një lokacion në tjetrin, në kontratën me titull "**Rregullimi dhe riparimi i terreneve sportive**", me nr. të prokurimit: 623-23-12344-5-2-1.
2. Ndryshimi (kolaudimi) i lokacionit sipas pikës 1 të këtij vendimi do të bëhet nga lokacioni për "**Rregullimin e fushës sportive në fshatin Mrasor**", në parcelën me nr. 71510052-00331-0, në lokacionin për "**Rregullimin e fushës sportive në fshatin Pataqan i Poshtëm**", në parcelën Nr. P - 71510024 - 00012- 47, pronë e Komunës, pa implikime financiare shtesë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Zyra e Prokurimit, menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Ofruesi i shërbimeve (punëkryesi) të projektit me titull "**Rregullimi dhe riparimi i terreneve sportive**", me Nr. të Prokurimit 623-23-12344-5-2-1, i ka rekomanduar menaxherit të kontratës më 16.7.2026 ndryshimin (kolaudimin) e lokacionit në projekt, me qëllim të përfundimit me sukses të këtij projekti.

Pas kësaj, menaxheri i kontratës, përmes rekomandimit për ndryshim të lokacionit, me nr. prot. 2902, të datës 29.7.2026, ka kërkuar nga Zyrtari Kryesor Administrativ ndryshimin (kolaudim) e lokacionit nga një lokacion në tjetrin në projektin me titull "Rregullimi dhe riparimi i terreneve sportive", me Nr. të Prokurimit 623-23-12344 -5-2-1 si në vijim: nga lokacioni për "**Rregullimin e fushës sportive në fshatin Mrasor**", në parcelën me nr. 71510052-00331-0, në lokacionin për "**Rregullimin e fushës sportive në fshatin Pataqan i Poshtëm**" në parcelën Nr. P- 71510024 - 00012- 47, pronë e Komunës, pa implikime financiare shtesë.

Ky ndryshim (kolaudim) i lokacionit është bërë me qëllim të vazhdimit të punimeve të këtij projekti pasi disa punime nuk mund të realizohen sikurse në lokacionin për “Rregullimin e fushës sportive në fshatin Mrasor” sepse parcela me Nr. 71510052-00331-0 nuk është pronë e Komunës por është në shfrytëzim të Agjencisë Pyjore të Kosovës, pasi është arritur dakordimi në mes të operatorit ekonomik, menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, ndryshimi i lokacionit të bëhet pa implikime financiare.

Pas konsultimit me Sektorin e Prokurimit, menaxherin e kontratës dhe mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë, si dhe pas vlerësimit të fakteve në shkresat e lëndës, është vendosur për ndryshimin e lokacionit në projektin e lartpërmendur.

Andaj, duke u bazuar në atë që u tha më lart, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- *Menaxherit të kontratës,*
- *Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë,*
- *Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport*
- *Zyrës së Prokurimit, dhe*
- *Arkivit.*

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA E KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC



Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 7706 Nr. i faq/Br.str/No.pg 73

Data/Datum/Date 30/07/26

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), dispozitave të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 18/2011, dispozitave të Rregullores Nr. 002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores NR. 001/2022 për Prokurimin Publik, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, kërkesës me nr. 2899, të datës 29.7.2026, për ndryshimin e lokacionit në projektin "Rregullimi dhe riparimi i terreneve sportive", kontratës me nr. të prokurimit 623-23-12344-5-2-1 dhe rekomandimit për ndryshim të lokacionit, menaxherit të kontratës me nr. prot. 2902, të datës 29.7.2026, kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

**Për ndryshimin (kolaudimin) e lokacionit në projektin me titull
"Rregullimi dhe riparimi i terreneve sportive"**

1. Me këtë vendim lejohet ndryshimi (kolaudimi) i lokacionit nga një lokacion në tjetrin, në kontratën me titull "**Rregullimi dhe riparimi i terreneve sportive**", me nr. të prokurimit: 623-23-12344-5-2-1.
2. Ndryshimi (kolaudimi) i lokacionit sipas pikës 1 të këtij vendimi do të bëhet nga lokacioni për "**Rregullimin e fushës sportive në fshatin Hoçë e Vogël**", në parcelën me nr. 71510005-01726-0, në lokacionin për "**Rregullimin e fushës sportive në fshatin Sapniq**", në parcelën Nr. P - 71510074 - 00510- 0, pronë e Komunës, pa implikime financiare shtesë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Zyra e Prokurimit, menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Ofruesi i shërbimeve (punëkryesi) të projektit me titull "**Rregullimi dhe riparimi i terreneve sportive**", me Nr. të Prokurimit 623-23-12344-5-2-1, i ka rekomanduar menaxherit të kontratës më 16.7.2026 ndryshimin (kolaudimin) e lokacionit në projekt, me qëllim të përfundimit me sukses të këtij projekti.

Pas kësaj, menaxheri i kontratës, përmes rekomandimit për ndryshim të lokacionit, me nr. prot. 2902, të datës 29.7.2026, ka kërkuar nga Zyrtari Kryesor Administrativ ndryshimin (kolaudim) e lokacionit nga një lokacion në tjetrin në projektin me titull "Rregullimi dhe riparimi i terreneve sportive", me Nr. të Prokurimit 623-23-12344 -5-2-1 si në vijim: nga lokacioni për "**Rregullimin e fushës sportive në fshatin Hoçë e Vogël**", në parcelën me nr. 71510005-01726-0, në lokacionin për "**Rregullimin e fushës sportive në fshatin Sapniq**" në parcelën Nr. P- 71510074 - 00510-0, pronë e Komunës, pa implikime financiare shtesë.

Ky ndryshim (kolaudim) i lokacionit është bërë me qëllim të vazhdimit të punimeve të këtij projekti, pasi disa punime nuk kanë nevojë të bëhen sepse te lokacioni për “Rregullimin e fushës sportive në Hoçë të Vogël”, në parcelën me Nr. 71510005-01726-0, është ndërtuar në kuadër të grantit të performancës të fituar nga Komuna e Rahovecit, pasi është aritur dakordimi në mes të operatorit ekonomik, menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, që ndryshimi i lokacionit të bëhet pa implikime financiare.

Pas konsultimit me Sektorin e Prokurimit, menaxherin e kontratës dhe mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë, si dhe pas vlerësimit të fakteve në shkresat e lëndës, është vendosur për ndryshimin e lokacionit në projektin e lartpërmendur.

Andaj, duke u bazuar në atë që u tha më lart, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- ***Menaxherit të kontratës,***
- ***Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë,***
- ***Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport***
- ***Zyrës së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës

